



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2404/17 Prot.

Pogradec, më 10 . 06 2026

VENDIM

Nr. 76, DATË 09/06 /2026

PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 46, DATE 29.05.2025 “PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 55 pikat 2 dhe 6, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, I ndryshuar, Ligjit nr. 156, datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, në nenet 12, 41 dhe 85 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Vendimi nr. 776, date 19.12.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”, “Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar, VKB-së nr. 24, datë 27.03.2025 “Për miratimin e tavaneve përgatitore buxhetore për Vitet 2026-2028”, VKB-së nr. 141, datë 27.12.2024 “Për miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për Vitin 2025”, VKB-së nr. 46, date 29.05.2025, si dhe referuar Kërkesave me nr. 1077 Prot, datë 05.03.2026 dhe nr. 1077/1 prot, date 04.05.2026, me lëndë “Kërkesë për rritje fondi” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,



VENDOSI:

1. Të miratojë kompensimin e pagës minimale Kontraktorit të shërbimit të pastrimit, për Marrëveshjen Kuadër me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative" nga muaji Janar 2026 e në vijimësi, sipas VKM-së nr. 776, date 19.12.2025 "Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi".
2. Fondi financiar për kryerjen e shërbimit mbetet i njëjtë, sa oferta financiare e kontraktorit mbi bazën e së cilës është nënshkruar marrëveshja kuadër, në vlerën prej 515 900 555, 62 (pesëqind e pesëmbëdhjetë million e nëntëqind mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë me tvsh.
3. Me akordimin e kompesimit të pagës minimale të kontraktorit, afati i marrëveshjes kuadër do të ndryshojë nga 48 muaj në 46 muaj, pasi me shtimin e fondeve për kompensim të pagës minimale brënda vlerës totale të përgjithshme, ulet afati kohor i shtrirjes së kësaj marrëveshje.
4. Fondi i përlogaritur për kompensimin e pagës minimale për vitin 2026 do t'i akordohet kontraktorit me nënshkrimin e minikontratës së radhës (korrik- dhjetor 2026).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Pogradec, Drejtorja e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i tokës bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve, Drejtorja e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Prokurimeve pranë Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë sipas përcaktimeve pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 13 **vota**

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 4

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 09.06.2026